VENDIM
Nr.874, datë 3.11.2010

PËR TRAJNIMIN E PERSONELIT TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE JOBUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 202, datë 17.12.2009 "Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. I gjithë personeli i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore duhet t'i nënshtrohet trajnimit, sipas programit përkatës, të hartuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

2. Programi i trajnimit të përbëhet nga pjesa e përgjithshme (A) dhe pjesa e veçantë (B).

2.1 Në pjesën e përgjithshme (A) është materiali i trajnimit për të gjithë personelin, që do të merret me regjistrimin, ku duhet të përfshihen njohuritë për:

a) qëllimin e regjistrimit, objektivin, përkufizimet dhe konceptet, bazën ligjore, mbrojtjen e të dhënave personale;

b) komponentët e pyetësorit, manualet e përdorimit, klasifikimet, teknologjinë e informacionit që do të përdoret, si dhe sistemet e hartografisë.

2.2 Në pjesën e veçantë (B) është materiali i trajnimit për kategorinë specifike të personelit, që do të merret me regjistrimin dhe konkretisht:

a) Për mbikëqyrësit, materiali i trajnimit duhet të përfshijë mënyrën e organizimit të punës në terren, çështjet e logjistikës dhe mënyrat e shpërndarjes e të grumbullimit të pyetësorëve, si dhe mënyrat e organizimit e të monitorimit të punës së kontrollorëve.

b) Për kontrollorët, materiali i trajnimit duhet të përmbajë mënyrën e punës në terren, çështjet e logjistikës dhe metodat e shpërndarjes e të grumbullimit të të dhënave, metodat e monitorimit e të kontrollit të cilësisë së punës së anketuesve.

c) Për anketuesit, veç pjesës së përgjithshme, trajnimi do të fokusohet edhe në njohjen me përmbajtjen e pyetësorit, mënyrat e plotësimit të tij gjatë intervistimit, përdorimin e pajisjeve GPS (Global Positioning System) në terren, si dhe mënyrat e raportimit e detyrat ndaj kontrollorit.

3. Trajnimi i stafit mbikëqyrës të kryhet me një grup për një periudhë jo më shumë se 5 (pesë) ditë.

4. Trajnimi i stafit kontrollor të kryhet me dy grupe për një periudhë jo më shumë se 5 (pesë) ditë për secilin grup.

5. Trajnimi i stafit anketues të kryhet me 30 grupe për një periudhë jo më shumë se 4 (katër) ditë.

6. Trajnimi i personelit të regjistrimit të përfundojë jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para fillimit të intervistimit në terren.

7. Ngarkohet INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi dhe për caktimin e trajnerëve përkatës për çdo grup.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha